

**Këshilli i Komunës së Kërçovës**

**Nr. 08-2010/2**

**15.08.2024**

**K ë r ç o v ë**

## **PROCESVERBAL**

**Nga seanca e 37-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 15.08.2024 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 09:00**

Seancën e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Kamerr Klosi, Migjen Zendeli, Drenuse Dalipi, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Valentina Llazaroska, Ivanço Bozhinoski, Viktor Aleksoski, Ramazan Zulbeari, Sibel Tufkegji dhe Agim Sadiku, Abdulla Sejdini, Valbona Adili Emini.

Në seancë i pranishëm ishte edhe Bojan Stojkoski-antarë i ri i këshillit të komunës së Kërçovës

Në mungesë ishën këshilltarët: Argjent Asani dhe Fortesa Sejdini.

Në seancë të pranishëm edhe Valdet Selimi, Bekim Mustafaj, Bujar Veseli, Fjolla Aliu, përfaqësues nga administrata komunale.

Kryetari i këshillit informon se Procesverbali paraprak nga seanca e 36-të nuk është i përkthyer për shkak të kohës së shkurtër dhe i njëjti do të vendoset për miratim në seancën e ardhshme.

Kryetari i këshillit për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

## **R E N D I I D I T Ë S**

1. Propozim Vendimi për ndërprerje të mandatit të antarit të Këshillit të Komunës së Kërçovës.
2. Verifikimi i mandatit të antarit të ri të Këshillit të Komunës së Kërçovës. • Raporti nga komisioni verifikues • Nënshkrimi i deklaratës solemne
3. Raporti kuartal i Komunës së Kërçovës për kuartalin e 2 nga 01.01.2024 deri 30.06.2024
4. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim në dokumentacionin urbanistik për f.Podvis – Kërçovë për përcaktimin e objektit pa leje.
5. Propozim- V E N D I M Për ndryshimin e Rregullores për përlllogaritjen e rrogës për nëpunësit publik në Komunën e Kërçovës
6. Propozim Vendimi për dhënjen e mendimit pozitiv të Planin vjetor për punësim në Komunën e Kërçovës për vitin 2025.
7. Raporti kuartal për të ardhurat dhe shpenzimet të NP. ‘Komunalec’ për kuartalin e 2.
8. Program Vjetor për punë edukativoarsimor të SH.F.Q ‘Milto Gurra’ për vitin 2024-2025.
9. Program Vjetor për punë edukativoarsimor të SH.F ‘Sande Shterjoski’ për vitin 2024-2025.
10. Program Vjetor për punë edukativoarsimor të SH.F ‘Rexho Rushiti Zajazi’ për vitin 2024-2025.
11. Program Vjetor për punë edukativoarsimor të SH.F.Q ‘Hristo Uzunov’ për vitin 2024-2025.
12. Program Vjetor për punë edukativoarsimor të SH.F ‘Faik Konica’ për vitin 2024-2025.
13. Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ ‘Gjergj Kastriot Skenderbeu’, për vitin shkollorë 2023-2024
14. Program Vjetor për punë edukativoarsimor të SH.F.Q ‘Gjergj Kastrioti Skenderbeu’ për vitin 2024-2025.
15. Program Vjetor për punë edukativoarsimor të SH.F.Q ‘Kuzman Josifoski Pitu’ për vitin 2024-2025.
16. Të ndryshme.

Kryetari i Këshillit Skender Xhabiri, pas leximit të rendit të ditës, hapi diskutim:

Agim Sadiku – I përshëndeti të pranishmit dhe kishte një vërejtje se pse nuk u mbajt Komisioni për Financa dhe Buxhet dhe kjo ishte hera e dytë apo e tretë që nuk mbahet komisioni, ndërsa pika e 3-të dhe e 7-të ishin në kompetencë të atij komisioni. Ai bën me dije se si anëtar i atij komisioni dhe anëtar i Këshillit, mendon se ai komision është dashur të mbahet. Mbajtja e komisioneve është detyrë ligjore dhe në të duhet të shqyrtohen pikat. Në procesverbal shihet se tashmë është bërë praktikë që komisionet të mos mbahen para seancave, për shkak të mosmbajtjes së komisionit, ai ka kërkuar që pika e 3-të dhe e 7-të të tërhiqen nga rendi i ditës për këtë seancë.

Kryetari i këshillit - bën me dije se pika e 7-të ka qenë nga “Komunalec”, e 3-ta nga komuna, dhe pajtohet që është dashur që të mbahet komisioni. Ai theksoi se komisioni nuk u mbajt, sepse disa ishin me pushime vjetore dhe gjithashtu Laze nuk është më këtu.

Agim Sadiku – Ai bën me dije se ka kërkuar që të respektohet Ligji, i cili në këtë rast nuk është respektuar. Fillimisht Komisioni për Financa dhe Buxhet nuk u mbajt dhe për këtë kërkon që pikat e rendit të ditës të tërhiqen. Së dyti, për shkak të situatës së përgjithshme që është krijuar me kanalizimin në nivel komunal, ka kërkuar që një përfaqësues nga administrata komunale apo kryetari i komunës të vijë në seancë dhe të japë raport apo informacion. Ai ka theksuar se për kërkesën në pikën „Të ndryshme,, nga seanca e kaluar, ka mundur që të thirrret Fisniku për të informuar për gjendjen që po ndodh me kanalizimin, për të cilën është dashur të njoftohen me shkrim, por nuk janë njoftuar. Ai ka kërkuar që të informohet për ato pika dhe kështu qytetarët do të jenë më të informuar, sepse edhe ata e kanë kërkuar.

Tefik Lutviu- Si kryetar i komisionit për financa ka bërë me dije se komisioni ka qenë i paraparë që të mbahet, por përshkak se nuk ka pasur kuorum, nuk ka pasur interesim nga anëtarët, nuk kanë shkuar në seancën e komisionit, prandaj ka kërkuar që komisioni të mos mbahet. Agimi kishte të drejtë që duhet të mbahen komisionet, por në seancat paraprake të komisioneve kanë marrë pjesë nga dy anëtarë, nuk kishte kuorum dhe nuk u mbajtën.

Agim Sadiku- Informon se ajo nuk është arsyetim, dhe se Kryesuesi gjithsesi është dashur ta caktojë komisionin, e nëse do të mbahej apo jo ajo është çështje tjetër, por është dashur të respektohet procedura. Ai theksoi se ka çështje që mund të shqyrtohen dhe të zgjidhen më mirë në komision me një përfaqësues nga sektori i financave, sesa në këshill. Prandaj u krijuan komisionet dhe duhej të ishin funksionale.

Kryetari i këshillit - Informon se në Këshill sërish vendoset për pikat, pavarësisht nëse është mbajtur apo nuk është mbajtur komisioni.

Agim Sadiku- Informon se ky nuk është arsytim.

Kryetari i këshillit e hodhi në votim propozimin e këshilltarit Agim Sadiku për tërheqjen e pikës së 3-të dhe të 7-të nga rendi i ditës dhe nuk u miratua me 8 vota PËR. Më pas, kryetari i këshillit e hodhi në votim propozimin për mosheqjen e pikave 3 dhe 7-të nga rendi i ditës dhe u miratua me 10 vota PËR, 1 votë PËRMBAJTUR..

Valentina Lazarevska - Ajo kërkoi që pikat e 8-të dhe të 10-të të tërhiqen nga rendi i ditës, sepse programet e shkollave nuk ishin të plota, kishin shumë lëshime, nuk ishin përgatitur sipas shembullit të dhënë dhe kishte joseriozitet nga ana e drejtorëve në përgatitjen e tyre.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim propozimin e këshilltares Valentina Lazarevska për tërheqjen e pikës së 8-të dhe të 10-të nga rendi i ditës dhe nuk u miratua me 7 vota PËR. Pas kësaj, kryetari i këshillit e vendosi për miratim që pika e 8-të dhe e 10-të 3 rendit të ditës të mos tërhiqen dhe i njëjti u miratua me 10 vota PËR dhe 3 vota PËRMBAJTUR.

Kryetari i këshillit theksoi se pikat mbeten në rend dite dhe se këshilli fillon të punojë sipas rendit të ditës.

Më pas, kryetari i këshillit e vendosi për miratim rendin e ditës për këtë seancë dhe i njëjti nuk u miratua me 10 vota PËR. 10 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

Pasi që rendi i ditës nuk u miratua, kryetari i këshillit e mbylli seancën në ora 9:30 dhe njoftoi se këshilltarët do të njoftohen se kur do të mbahet seanca e radhës.

Procesverbalist

-Lençe Srbinoska

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Skender Xhabiri d.v.

Përkthyes:Tefik Asani

